

NË KËTË NUMËR

Unioni i qytetarëve sjell rregulloren në nivel qendror **2**

Dhjetë dobësitë kryesore të OJQ-ve kosovare **2**

Fushatat e sukseshme avokuese të OJQ-ve **2**

Rast studimi: Si avokuan qytetarët me sukses për shkollën në vitin 1995 **3**

Këshilla për uljen e shpenzimeve në punën avokuese **3**

Si mund ta mbajmë veten të përgjegjshëm? **3**

Shtatë hapa drejt avokimit të suksesshëm **4**

Trajnimi i dytë javor i ATRC-së **4**

Artikull i huazuar: Anëtarja e LDK-së u soll keq me gratë **4**

VEND I HAPUR PUNE

**ATRC
po kërkon një
Menaxher/e
Programi për
kohë të pjesshme**

Kontaktoni ATRC-në për më shumë informata.



Shoqëria civile merr kritika. Të merituarat?

12 korrik - PRISHTINË. Instituti Kosovari për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) ka lansuar në publik raportin e vet "Shoqëria civile në tranzicion: sektori i OJQ-ve në Kosovën e pasluftës" në ATRC. Raporti ka ngritur çështjet e njëjta që janë ngritur kohë pas kohe lidhur me imazhin publik të organizatave joqeveritare (OJQ). Megjithatë, këtu u përmendën disa zgjidhje të reja.

ATRC-ja dhe partneri i saj Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI), pas punës direkte me OJQ-të dhe të qenurit ekspertë mbi çështje të tilla, ndjejnë se njëra nga zgjidhjet është edhe investimi afat-gjatë në shoqërinë civile që do t'i aftësonte OJQ-të për t'u bërë agjentë të qëndrueshëm të ndryshimeve. Përmes Projektit të OJQ-ve Kosovare në Avokim (KNAP), ne jemi përpjekur ta bëjmë këtë duke i siguruar OJQ-ve trajnime avokimi dhe të organizimit të brendshëm dhe duke iu ndihmuar atyreve që të ngrejné imazhin e tyre publik.

Tregues kyç, se OJQ-të janë bërë publikisht të njohura si agjentë të shoqërisë civile, do të jetë kur ato të fillojnë të pranojnë financim vendor (i cili varet pjesërisht nga ekonomia gjysëm e zhvilluar).

Vetëm disa OJQ e kanë bërë këtë. Ato poashtu kanë qenë shumë efektive pasi jo vetëm që kanë pasur çështjet e duhura në mendje, por edhe kanë fituar përkrahjen publike për iniciativat e tyre. Disa nga këto shembuj



Qytetarët dëshirojnë të dinë:
A fitoni më shumë se 250 € në muaj?
A vozit OJQ-ja juaj xhip? Çfarë rezultatesh konkrete mund të tregoni nga konferencat dhe tryezat tuaja të rumbullakta?

janë treguar në faqet vijuese si raste studimi. Prapë, siç e kemi theksuar shumë herë të tjera, realiteti është se shumë OJQ janë krijuar si mundësi pune, sesa si përgjegjësi qytetare. Qytetarët nuk janë të ngadalshëm ta vërejnë këtë, çka tregon edhe arsye se pse ata janë

"E tëra është në qasje.

Njerëzit që pozicionohen në makina katër rrotëshe nuk do të dëgjojnë problemet e vërteta të komunitetit. Ato duhet të ndërtojnë një raport besimi para se njerëzit ta thonë të vërtetën." - aktivist vendor

të ngadalshëm që t'i përkrahin OJQ-të, sidomos financiarisht.

"Shumë kosovarë e shoqërojnë emrin OJQ me grupe të vogla të individëve që ngasin xhipa dhe sjellin në shtëpi një rojë të majme, duke shpenzuar shumicën e kohës duke ndjekur donatorët, fondet e të cilëve ata i harxhojnë duke organizuar trajnime të mëdha, konferenca dhe tryeza të rumbullakta të pakuptimta" përkrahur më saktësisht autori i raportit Besnik Pula.

Ironikisht, shumë OJQ kalojnë orë (nëse jo publikisht nëpër kon-

ferenca të padobishme, atëherë privatisht duke pirë kafe me miq) duke kritikuar në mënyrë hipokrite partitë politike dhe OJQ-të e tjera për joprofesionalizëm dhe që nuk komunikojnë me qytetarët. Ata rrallë shikojnë në pasqyrë për të zbuluar se janë në kafene apo dhomë konference, në vend se të jenë jashtë për të kontaktuar me qytetarët që të zbulojnë nevojat e vërteta të komunitetit.

Derisa OJQ-të pijnë kafe dhe kritikojnë njëra-tjetrën, ne jemi duke e humbur shpejt besimin nga publiku, tek i cili do të mbështetemi së shpejti për përkrahje. Kjo nënkupton se aktualisht ne mund të përfitojmë nga kjo situatë ku zyrtarët qeverisës kanë mungesë përvoja dhe ekspertize për aprovimin e legjislacionit. Megjithatë, për të avokuar efektivisht në të ardhmen, OJQ-të duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me qytetarët për të fituar mbështetjen e nevojshme financiare dhe njerëzore për të shtyrë përpara ligjet dhe rregulloret.

Siç tha Xhemë Shehu, drejtor i Epokës së Re në Deçan, "sukseset e fushatave të avokimit deri më tani janë arritur bazuar në dobësitë e qeverisë sesa në forcat tona. Tani ne duhet të angazhohjmë më shumë qytetarë për të ndikuar me të vërtetë në ndryshime".

Përmes këtij numri të "Avokimit," ne synojmë të adresojmë komentarin e z. Shehu dhe përfundim të dytë të raportit të KIPRED-it se "ndikimi direkt i shoqërisë civile mbi procesin e politikave është ende mjaft i dobët" duke ofruar shembuj konkretë të avokimit efektiv. ■

Kritikat kryesore të raportit të KIPRED-it

- Shumë OJQ kanë mungesë të organizimit të brendshëm, ekspertizës dhe profesionalizmit;
- Shumica e gërshetojnë tërë autoritetin dhe reputacionin mbi një individ të vetëm [Drejtorin];
- Mund të ketë patur shkapërderdhje të fondeve mbi projekte relativisht të parëndësishme dhe me ndikim të ulët;
- OJQ-të formohen që të përfitojnë nga mundësitë e financimit, pavarësisht nga dobishmëria apo efektiviteti i programeve që ata zbatojnë [...Ato] kanë tendencë që të organizohen drejt ofrimit të shërbimeve (siç janë programet një javore trajnime) kundrejt lobimit për të drejta të grave apo kërkimit për përfaqësim më të madh politik.

Fushata të sukseshme avokimi nga OJQ-të

Ne i pyetëm aktivistët e OJQ-ve nëpër tërë Kosovën se cilat ishin fushatat më të sukseshme avokuese. Ata përmendën këto:

Liria e Informimit: me ekspertizë të Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe mbështetje nga Article 19, një koalicion i OJQ-ve bashkëpunuan me sukses për aprovimin e legjislacionit për Lirinë e Informimit. Gjatë procesit, ata poashtu ndëruan kredibilitetin e OJQ-ve në mesin e legjislatorëve.

Handikos: qytetarët e bashkuar nëpër Kosovë për të avokuar me sukses për platformat e karrocave të invalidëve jashtë ndërtesave publike.

Grupi Kosovar për Iniciativa Lokale dhe Rajonale: ka studiuar raste ndërkombëtare, ka punuar me ekspertë, ka bashkëpunuar me koalicionin e OJQ-ve dhe përmes një fushate derë më derë, do ta përfshijë komunitetin për të avokuar për aplikimin e mekanizmit të referendumit për vendim-marrje në komunën e Prizrenit.

Forumi i OJQ-ve nga Gjakova: koalicioni i OJQ-ve ka bashkëpunuar në hartimin e rregullores për zbatimin e klauzave nga statuti komunal i Gjakovës mbi konsultimet dhe pjesëmarrjen publike.

Epoka e Re në Deçan: duke u bazuar në metodologjinë e OJQ-ve ka hartuar me sukses një rregullore për zbatimin e statutit komunal të Deçanit mbi pjesëmarrjen publike.

Asociacioni i Intelektualëve të Pavarur në Deçan: ka punuar ngushtë me institucionet dhe ka avokuar me sukses për aprovimin e një rregulloreje mbi caktimin e vendeve të duhura për deponimin e hekurishteve.

Vizioni drejt Ardhmërisë: ka hartuar një strategji zhvillimore për komunën e Shtimjes. Ata kërkuar aktivisht kontributin e qytetarëve për strategji përmes debateve publike. Ata poashtu përfshinë shumë akterë, përfshirë këtu edhe institucionet qeverisëse vendore, unionet dhe sindikatat e punës. ■

Unioni i qytetarëve e sjell rregulloren në nivelin qendror

Bordi i drejtorëve të Pejës dhe Komiteti për Politika dhe Buxhet kanë aprovuar rregulloren kundër pirjes së duhanit në vende publike të hartuar nga Unioni i Qytetarëve të Pejës, një projekt i financuar nga FDI-ja. Kuvendi komunal u pajtua që së shpejti të aprovojë një pjesë të rregullores. Megjithatë, disa pjesë të rregullores ishin jashtë kompetencave të kuvendit.

Qeveria komunale ushtron kontroll mbi pirjen e duhanit në shkolla, spitale dhe institucione publike, por jo mbi restorante, transport dhe vende të tjera publike. Këto fusha janë nën kompetencat e qeverisë qendrore, prandaj Unioni i Qytetarëve iu bashkua një grupi punues për ta hartuar gjithashtu një rregullore në nivel qendror. Grupi shpreson që të ndikojë tek vendim-marrësit për të përfshirë tek rregullorja qendrore

pjesët e lëna anash në rregulloren komunale.

Metodologjia e tyre përfshin 1) hartimin e pyetësorit dhe reagimin e komunitetit; 2) mbajtjen e tryezave të rumbullakëta me qytetarët dhe përfaqësuesit e qeverisë; 3) formimi i një grupi ekspertësh për hartimin e rregullores; dhe 4) përfshirja e mediave në fushatat e edukimit publik.

Çfarë është e suksesshme rreth metodologjisë së tyre?

Unioni i Qytetarëve i pyeti qytetarët rreth opinionit të tyre dhe ofroi një mundësi për qytetarët që të përfshihen në vendim-marrje në sfera të tjera, përveçse përmes partive politike. Poashtu, kur unioni u përball me probleme gjatë aprovimit të të gjitha rregulloreve në nivel lokal, ata avokuan në nivel qendror.



Unioni i Qytetarëve ka fituar me sukses përkrahjen e përdoruesëve dhe jopërdoruesëve të cigares për rregulloren kundër pirjes së duhanit në vende publike.

Si mund ta përmirësonin fushatën e tyre?

1) Në vend se të varen vetëm nga puna e gazetarëve, ata është dashur që t'i shkruajnë vetë artikujt e tyre rreth kësaj çështje; 2) të formonin një strategji konkrete për zbatimin e rregullores së re; 3) të mobilizonin më shumë qytetarë, sidomos studentët që do t'i përkrahnin ata në fushatën e tyre. ■

Dhjetë dobësitë kryesore të OJQ-ve kosovare

I kemi pyetur aktivistët e OJQ-ve nëpër tërë Kosovën se cilat mendojnë se janë dobësitë e OJQ-ve dhe sipas tyre ato janë:

1 Të orientuar sipas donatorëve. Shumë OJQ vrapojnë pas të hollave për projekte në vend se të zgjedhin projekte të cilat përputhen me misionin e organizatës së tyre.

2 Planifikimi afatshkurtër. Derisa OJQ-të janë të zëna me zbatimin e projekteve të tyre aktuale, ato shpesh harrojnë të mendojnë për të ardhmen e tyre. Kjo përfshin hartimin e një plani strategjik, që punon drejt misionit dhe synimeve të organizatës dhe nuk është i bazuar vetëm në donatorë ose projekte.

3 Organizimi i brendshëm. Shumë OJQ duhet t'i rishqyrtojnë misionet, vizionet dhe rregulloret e tyre për t'u siguruar që i përshtaten punës së tyre dhe që nuk janë kopje e mate-

rialeve të organizatave të tjera.

4 Të fokusuar në hartimin e propozimeve. Shumë OJQ shpenzojnë më shumë kohë për hartimin e një projekti, sesa për zbatimin e tij.

5 Puna e pakryer. OJQ-të shpesh dorëzohen shumë lehtë kur përballen me probleme, sesa përpiqen që ta zgjidhin problemin dhe përfundojnë atë që kanë nisur.

6 Frika. Shumë OJQ frikohen që t'i adresojnë në mënyrë efektive çështjet e mëdha si korrupsioni (p.sh. të shkruajnë në gazeta artikuj ku emërtohen individët specifikë dhe përfshirja e tyre në aktivitete korrupsive kundrejt metodave më pak efektive).

7 Mburja. OJQ-të që janë më së shumti aktive dalin më rrallë në media, ndërsa ato që janë më së shumti të orientuara nga donatorët me buxhete të mëdha janë në media tërë kohën, por tregojnë vetëm pak rezul-

tate të vërteta.

8 Puna ekipore. Shumë OJQ punojnë më tepër individualisht si brenda ashtu edhe jashtë.

9 Dembelia. Avokimi efektiv kërkon mjaft përpjekje, duke përfshirë hulumtimin e duhur të çështjes dhe zgjidhjet e mundshme, fitimin e përkrahjes publike, avokimin në qeveri, tejkalimin e problemeve të papritura, kryerjen e punëve të filluara edhe nëse buxheti i vien fundi dhe sigurimi se rregulloret janë zbatuar pasi të jenë aprovuar.

10 Rivlerësimi dhe të qenurit unik. Shoqëria civile ka tendencën të tejvlerësojë. Për shembull sa dokumente janë shkruar rreth ngjarjeve të marsit? Ne ende mund të vlerësojmë çfarë ndodhi kur të ndodhë sërish, pasi vetëm disa OJQ kanë vepruar për zbatimin e rekomandimeve të parashtruara në raportet e mëparshme. ■

A dini për ndonjë fushatë të sukseshme avokimi nga OJQ-të? A dini për ndonjë fushatë avokimi nga OJQ-të që mund të ishte bërë më mirë? Na shkruani dhe na tregoni për këto. Ne do t'i përfshijmë këto informata (anonimisht nëse dëshironi) në numrin tonë të ardhshëm - le të punojmë së bashku për të mbajtur OJQ-të të përgjegjshme ndaj standardeve më të larta dhe për të përmirësuar imazhin tonë publik: info@advocacy-center.org

Rast studimi për metodat e avokimit të bazuara në komunitet: Si kanë avokuar qytetarët me sukses për shkollën

Çështje metodologjike: Çfarë bëjnë Motrat Qiriaz

- 1 Hetuan problemin.
- 2 Diskutuan me qytetarët për të mësuar më shumë dhe identifikuar nevojat e qytetarëve.
- 3 Me përfshirjen e qytetarëve, ndërtuan një rast për punë avokuese.
- 4 Kanë avokuar me përkrahjen e qytetarëve.
- 5 Treguan nevojën për fonde tek pjesëtarët e komunitetit vendor dhe të diasporës për të mbledhur fonde.
- 6 Ndërtuan shkollën.

Shtatë hapa për avokim të suksesshëm

1. **Çështja:** problemi i cili kërkon veprim politikash.
2. **Synimi dhe Objektivat:** synimi është deklarata specifike, e matshme dhe reale e rezultatit të përgjithshëm të cilin dëshironi ta arrini. Objektivat janë hapat plotësues drejt arritjes së synimit.
3. **Audienca e synuar:** hartuesit e politikave tek të cilët ju mundoheni të ndikoni për të përkrahur çështjen tuaj (p.sh. parlamentarët, zyrtarët vendorë, zyrtarët e ministrisë)
4. **Zhvillimi i porosisë:** krijimi dhe shpërndarja e porosisë.
5. **Kanalet e komunikimit:** televizioni, radioja, konferencat e shtypit, takimet kokë më kokë, tryezat e rrumbullakta, dëgjimet publike, debatet, fletushkat, etj.
6. **Ndërtimi i përkrahjes:** ndërtimi i aleancave me grupe, organizata apo individë të tjerë që janë të angazhuar për ta mbështetur çështjen tuaj. Kjo përfshin krijimin e marrëdhënieve me qytetarët si edhe me qeverinë. Pavarësisht nëse marrëdhënia ka qenë formale apo joformale, ndikimi dhe përfitimi reciprok janë pjesa më e rëndësishme.
7. **Monitorimi dhe vlerësimi:** i fushatës tuaj avokuese. Çfarë rezultatesh mund t'i tregoni publikut? ■

Në vitin 1995, qytetarët bashkëpunuan në "avokim" të bazuar në komunitet për të hapur shkollën e parë të mesme në zonat rurale të Hasit.

Kur Motrat Qiriaz, një organizatë joqeveritare vendore (OJQ) filloi punën me gra në rajonin e Hasit, ato zbuluan se vetëm disa femra kanë qasje në arsimin e mesëm. Ato organizuan takime me komunitetin për të gjetur arsyen e kësaj dukurie.

Pjesëtarët e komunitetit sqaruan se ata nuk dëshironin që vajzat e tyre të vijojnë shkollën në Prizren për shkaqe sigurie. Përfaqësues nga Motrat Qiriaz sugjeruan që atëherë ta sjellin shkollën tek qytetarët.

Ato filluan me punën e tyre avokuese duke organizuar takime individuale dhe grupe për të mbledhur informata rreth asaj se sa njerëz nuk mund të kenë qasje në arsimin specifikisht femrat. Ato e dërguan informatën tek Ministria e Arsimit dhe kërkuar leje për të ndërtuar shkollën. Pas disa muajsh avokimi, ministria më në fund e dha lejen e ndërtimit.

Pasi qeveria nuk mund të ofronte fonde për ndërtim, komuniteti filloi të tërheqë fonde si në nivel vendor ashtu edhe ndërkombëtar. Ata udhëtuan në Evropë, nëpër vende ku ndodhej diaspora duke organizuar takime për të sqaruar se



Motrat Qiriaz punuan me qytetarët për të avokuar dhe ngritur fonde për shkollën në fshatin Gjonaj.

psë iu nevojitej shkolla. Brenda disa muajsh ata mbledhën mjaft fonde për ndërtim.

Me buxhet të kufizuar dhe pa donator të madh, Motrat Qiriaz punuan me njerëz vendorë për avokim me bazë në komunitet. Në vend se të merre të holla për të bërë punë avokimi, komuniteti mbledhi fonde vetëm pasi që kishte identifikuar dhe prezantuar publikisht çështjen.

Nëse çështja është e rëndësishme, të hollat vijnë. Megjithatë, pa përkrahjen e qytetarëve fushatat avokuese do ta humbin efektivitetin e tyre në të ardhmen e afërt.

Përderisa donatorët largohen nga Kosova, OJQ-të do të duhet të punojnë më afër me komunitetin për të qenë të qëndrueshëm. Komuniteti mund të ofrojë përkrahje për fushata të suksesshme avokimi si dhe të kontribuojë me të holla në fushata që adresojnë çështje që janë të rëndësishme për ta. ■

Si mund t'i ulin OJQ-të shpenzimet në avokim

Dy aktiviste nga Motrat Qiriaz ofruan disa shembuj të mënyrave të tjera për të ulur shpenzimet e fushatave avokuese. Ja disa nga këshillat:

- **Paraqitja në TV për më pak para:** në vend se të thoni "ne duam të bëjmë një shou, sa kushton?", thoni "Ne do të bëjmë një projekt avokimi për të ndihmuar komunitetin. Ne dëshirojmë ta bëjmë atë përmes stacionit tuaj, pasi e dimë se ju brengoseni për zhvillimin e komunitetit tuaj. Në të njëjtën kohë, ne mund t'ju ofrojmë këtë shumë dhe t'ju ndihmojmë gjithashtu." Në këtë mënyrë, ju mund të zgjidhni një çmim më të ulët dhe njëkohësisht ta bëni fushatën tuaj më shumë një projekt të bazuar në komunitet duke i përfshirë mediat në "bashkë-avokim".
- **Radio falas:** shkoni në radiostacion dhe shpjegoni se jeni duke bërë një projekt për përfitime të komunitetit. Thuajuni se ju jeni poashtu duke i mbushur orët e tyre. Derisa ata duhet t'ju paguajnë, ju mund të pajtohni ta bëni falas.
- **Tryezat e rrumbullakta dhe takimet:** nëse ju jeni OJQ e bazuar në komunitet, formoni një këshill komuniteti, duke përfshirë si meshkuj, ashtu edhe femra. Së bashku me këshillin identifikoni nevojat kyçe të komunitetit. Pastaj, diskutoni nevojën me tërë komunitetin, fitoni mbështetjen e tyre dhe avokoni për çështjen së bashku. Duke biseduar direkt me pjesëtarët e komunitetit sqaroheni porosinë tuaj. Kjo është më e mirë sesa posterat ose fletushkat dhe më pak e shtrenjtë.

Si mund ta mbajmë veten të përgjegjshëm?

Për shumë OJQ, perceptimi i donatorëve është më i rëndësishëm se i qytetarëve pasi që fokusi kryesor i tyre është financimi sesa brengat e komunitetit.

Megjithatë, kjo qasje është e gabuar. Para se dikush të formulojë një strategji konkrete të mbledhjes së fondeve, duhet që së pari të caktojë caqet dhe të hartojë planin strategjik si organizatë. Kur OJQ-ja të identifikojë nevojat e vërteta të komunitetit dhe fokusohet në çështje konkrete, fondet do të vijnë.

Kjo qasje është mjaft e rëndësishme. Derisa donatorët e

mëdhenj ndërkombëtarë largohen, OJQ-të duhet të varen gjithnjë e më shumë tek vendorët dhe diaspora për donacione. Në të kaluarën, diaspora ka mbështetur iniciativat nga komuniteti dhe reagoi sidomos për projektet transparente që treguan rezultate konkrete.

Duke ecur përpara, OJQ-të nevojitet që të adresojnë çështje të vërteta në mënyrë që të marrin fonde nga komuniteti dhe diaspora. Përveç kësaj, ata duhet të demonstrojnë transparencë dhe standarde të larta në mënyrë që të pranojnë fonde nga vendorët dhe dias-

pora.

Njëra nga mënyrat për ta bërë këtë është duke ndjekur Kodin e Sjelljes. Një Kod i Sjelljes është sikur një rregullore, ku një ombrellë e OJQ-ve zgjedh që të ndjekë një seri standardesh dhe regullon veten për të fituar besim nga institucionet qeveritare dhe populli. Tashmë është formuar grupi punues për të filluar hartimin e Kodit të Sjelljes të OJQ-ve në Kosovë. Për të mësuar më shumë rreth Kodit të Sjelljes ose kontributit për hartimin e tij, ju lutemi të kontaktoni ATRC-në në info@advocacy-center.org. ■

ATRC-ja mban javën e dytë të trajnimit vjetor

14-17 korrik - Prishtinë. ATRC-ja organizon javën e dytë trajnuese të OJQ-ve kosovare për këtë vit, duke synuar kryesisht OJQ-të që janë përfituese potenciale të granteve të Projektit të OJQ-ve Kosovare në Avokim (KNAP). Java e trajnimit kombinoi tri trajnime të ndryshme.

Së pari, "Hapat e Suksesshëm për Fushata Avokimi", i mbajtur më 14-15 korrik u fokusua në çështje siç janë: çfarë është avokimi dhe politika publike; hapat në procesin e avokimit; dhe ndërtimi i rrjeteve dhe plani i zbatimit për fushatën e avokimit.

Së dyti, "Menaxhimi i OJQ-ve" i mbajtur më 16 korrik u fokusua në çështjet e lidhura me strukturën e OJQ-ve; rëndësinë e planifikimit

strategjik; mbledhjen e fondeve dhe strukturën e projektit.

Së treti, "Vetëdijësi-mi Gjnor" i mbajtur më 17 korrik u fokusua në çështjet gjinore, nevo-

jat gjinore, marxhinalizimin gjinor në një organizatë dhe/ose fushatat e avokimit.

Këto punëtori u vijuan nga dyzet udhëheqës të OJQ-ve, anëtarë, vullnetarë dhe studentë universiteti nga rajone të ndryshme të Kosovës. Ata fituan një përvojë dhe shkathtësi themelore për punën avokuese. Në këto trajnime pjesëmarrësit



Mentor Thaqi udhëhoqi trajnimin mbi "Hapat e suksesshëm për fushata avokimi" më 15 korrik në ATRC.

poashtu zhvilluan ide konkrete mbi përpjekjet avokuese që mund t'i ndërmarrin për të kontribuar në komunitetin e tyre. Pas përfundimit të këtyre trajnimeve, shumë OJQ apl-kuan për fonde tek Fondacioni për Iniciativa Demokratike. ATRC-ja do të organizojë trajnime të ngjashme në shtator 2004. ■

Rr. Agim Ramadani, Nr. 15

(ish Ramiz Sadiku)

Kati i dytë

Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 38 244 810

Fax: +381 38 244 810

Email: info@advocacy-center.org

Drejtor

KRESHNIK BERISHA

keka@advocacy-center.org

Menaxhere e

Përgjithshme

KIMETE KLENJA

kimete@advocacy-center.org

Menaxhere e Trajnimeve

NATYRA ZHJEQI

natyra@advocacy-center.org

Përgjegjëse për

Informim dhe

Marrëdhënie me Publik

NICOLE FARNSWORTH

nicole@advocacy-center.org

Koordinatorë për

Informim dhe

Marrëdhënie me Publik

DAFINA ZHERKA

dafina@advocacy-center.org

Administrator Zyre

GANI ASLLANI

gani@advocacy-center.org

A keni vërejtur ndonjë ndryshim në këtë numër të "Avokimit"?

Ju lutemi, dërgoni mendimet tuaja mbi atë se çka ju pëlqen dhe çfarë dëshironi të shihni të përmirësuar aty duke shkruar në info@advocacy-center.org

Artikulli i huazuar i rishtypur: *Kosova Sot dhe Epoka e Re* më 16 korrik

Melihatë Tërmkollit u soll keq me gratë

Nga Bordi i RRGK-së Prishtinë, 15 korrik - Një grup përfaqësuesesh të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RRGK), janë takuar të mërkurën me gra anëtare të Kuvendit të Kosovës nga shumica e grupeve parlamentare, me ç'rast prezantuan idenë e tyre për vazhdimin e fushatës "Gratë propozojnë", e cila do t'i shërbejë përkrahjes së grave kandidatë gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme që do të mbahen në tetor të këtij viti. Gratë parlamentare dhanë sugjerimet e tyre për fushatën si dhe iniciativa të tjera ligjore dhe të edukimit publik.

Ky takim është në vazhdimin e bashkëpunimit gjithnjë në rritje mes grave në politikë dhe atyre nga shoqëria civile. Takimi u organizua me përkrahjen e zyrës së fondacionit Fridrih Ebert Stiftung në Prishtinë.

Fatkeqësisht, gratë anëtare të

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) [partia që aktualisht mban shumicën e vendeve në kuvend] nuk morën pjesë në këtë takim. Madje, Znj. Melihatë Tërmkollit, Drejtuese e Forumit të Gruas së LDK-së, e cila mban edhe postin e kryetares së Komisionit Parlamentar për Barazi Gjinore, bëri edhe skena jashtë sallës së konferencës para takimit. Ajo demonstroi publikisht mungesë të thellë respekti dhe mirësjelljeje ndaj përfaqësuesve të RRGK-së.

Qëndrime të tilla pengojnë përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore in Kosovë, një qëllim për të cilin është edhe i mandatuat Komisioni Parlamentar për Barazi Gjinore. Për më tepër, qëndrimi i këtillë dëshmon moskuptimin e rolit shumë të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm të shoqërisë civile në ndërtimin e institucioneve demokratike në Kosovë.

RRGK-ja është një rrjet i më shumë se 50 OJQ-ve të Grave nga të gjitha rajonet e Kosovës. Rrjeti mbron dhe përkrah të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pavarësisht nga feja, përcaktimi politik, mosha, niveli i edukimit, orientimi seksual dhe aftësitë. RRGK-ja bashkëpunon me shumë rrjete kryesore të grave dhe të OJQ-ve të tjera në Kosovë, rajon dhe botë.

Deputetja Tërmkollit njihet si person që në paraqitjet e saj publike nuk ka demonstruar kurrfarë mirësjelljeje. Për shembull, gjatë Kuvendit të degës së LDK-së në Lipjan, znj. Tërmkollit iu kërcënua dhe e fyu njërin nga veprimtarët më të hershëm të LDK-së në këtë komunë. Qysh nga rizgjedhja e saj si kryetare e Forumit të Gruas së LDK-së ajo u soll në mënyrë autoritare. Artikuj reagimi ka pasur edhe lidhur me këto ngjarje. ■

Pse pikërisht ky artikull?

Në vend se të pritej që mediat të shkruanin artikull rreth punës së tyre, RRGK-ja mori iniciativën për të shkruar dhe publikuar këtë artikull. Artikulli bën dy gjëra. Së pari, i tregon publikut rreth punës së OJQ-ve, që mbështet një imazh pozitiv publik si dhe shkëmben informata rreth projektit të RRGK-së. Së dyti, artikulli kritikon hapur, me emra, politikanët e pagatshëm për bashkëpunim të cilët mund të ndikojnë negativisht në votat e partisë në zgjedhjet e ardhshme dhe mund t'i bëjë presion partisë që të dëgjojë më shumë brengat e shoqërisë. Bazuar në këtë numër të "Avokimit", i cili diskuton mënyrat për të përfunduar avokimin tonë, edhe kjo gjë demonstroi një formë të avokimit: shkrimin e artikujve.